

Ditari Natyres

"Ky botim është bërë i mundur nga një grant i REC Shqipëri në kuadër të programit SENIOR-A
"Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri". Ky program është financuar nga Qeveria Suedeze"
Nr. 30 Viti i tretë i botimit Nëntor 2015

Në këtë numër do të gjeni:

- ... me këtë rast Ju kujtojmë se ...
- Robërimi i Ujit
- Turizmi në Zonat e Mbrojtura
- Rugëtimi drejt Parisit 2015
- Vendet e Adriatikut, të bashkuar për të luftuar shpimet për naftë Adriatik
- Workshop informativ - Milieucontact
- Ndikimet mjedisore që vijnë nga aktiviteti minerar në Bulqizë - Danjel Bica (Ekspertët e Rinj Mjedisor)
- Njoftime

... me këtë rast Ju kujtojmë se 49 vjet më parë ...

... me VKM nr. 96, datë 21.11.1966 shpallen Parqe Kombëtare, kryesisht ekosistemet pyjore, si më poshtë:

1. Thethi, me sip. 2630ha; 2. Lura, me sip. 1280ha;
3. Llogara, me sip. 1010ha; 4. Bredhi i Drenovës, me sip. 1380ha; 5. Dajti, me sip. 3300ha dhe 6. Pisha e Divjakës, me sip. 1250ha.

Aktualisht, bazuar në dispozitat e ligjit "Për zonat e mbrojtura", të ndryshuar, disa prej tyre kanë ndryshuar sipërfaqen, duke ruajtur statusin e Parkut Kombëtar.

Vijon në faqe 2



Parku Kombëtar Theth © Foto INCA

Organizatrat partnere të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës



SHOQATA MJEDISORE CAJUPI
Bashkejto me Natyrën



QENDRA RAJONALE E MJEDISIT
Shqipëri



Mbështetje për Organizatat Mjedisore
të Shoqërisë Civile në Shqipëri



Vijon nga faqe 1 Parku Kombëtar “Thethi”, sipas studimit të ri që po kryhet, do të përfshihet në sipërfaqen e Parkut Kombëtar Ndërkufitar “Alpet e Shqipërisë”, me sipërfaqe të përgjithshme 86 mijë ha.

Parku Kombëtar “Dajti”, me VKM nr. 402, datë 21.06.2006, u rishpall “Park Kombëtar” me sipërfaqe të zgjeruar 29,384.18ha, i shtrirë në Qarkun e Tiranës dhe të Durrësit.

Parku Kombëtar “Pisha e Divjakes”, me VKM nr. 687, datë 19.10.2007, u rishpall Park Kombëtar “Divjakë-Karavasta”, me sipërfaqe të zgjeruar 22.230.2 ha, në të cilin përfshihet edhe pjesa e territorit në administrim të Kavajës (Gosë) dhe Fierit (Libofshë). Gjithashtu, pjesë e Parku Kombëtar, u bë dhe laguna e Karavastasë, me sip. 5000 ha, e cila sipas VKM nr. 102, datë 15.1.1996 kishte statusin “Rezervat Strikt Natyror”. Njëherazi, ky territori, si ekosistem natyror veçanërisht i mbrojtur, ka statusin e Zonës Ramsar, me VKM nr. 413, datë 22.8.1994...

... 10 vjet më parë ...

... me VKM nr. 684, **datë 02.11.2005**, shpallet zona shqiptare e Liqenit të Shkodrës “Rezervat Natyror i Menaxhuar”, ndërsa me VKM nr.682, **datë 02.11.2005**, shpallet “Peizazh ujor/tokësor i mbrojtur” zona e lumit Buna, së bashku me delten dhe ishullin e Franc Jozefit, rezervatin e Velipojës, lagunën e Vilunit, plazhin e Baks-Rrjollit, kënetën e Domnit, si dhe territoret përreth tyre.

Për Rezervatin Natyror të Menaxhuar “Liqeni i Shkodrës” është hartuar dhe plani i menaxhimit (Qershor të vitit 2012), i miratuar me urdhër të Ministrit të Mjedisit nr. 815, datë 21.11.2012, por që fatkeqësisht nuk po zbatohet, pasi ka disa kundërshti në lidhje me zonimin e territorit dhe të mungesës së fondeve.

Me VKM nr.683, **datë 02.11.2005**, sipërfaqja prej 49,562.0ha, e cila përfshin Liqenin e Shkodrës sëbashku me Lumin e Bunës dhe zonat ligatinore përreth tyre, të shpalljen zonë natyrore veçanërisht të mbrojtur dhe përfshirjen në listen e Konventës “Ramsar”, “Për ligatinat me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate të shpendëve ujore”.

... 5 vjet më parë ...

... me VKM nr.995, **datë 03.11.2010**, ekositemi natyror ligatinor i deltës së Lumit Mat, laguna e Patokut, Godulla dhe delta e Lumit Ishëm, me sip. 5000.7ha, shpallet “Rezervat Natyror i Menaxhuar”.

VKM nr.693, **datë 10.11.2005**, rishpall “Park Kombëtar” territoret natyrore të kompleksit ligatinor të Butrintit deri tek Kepi i Stillos, me sip. 8591.2ha. Për këtë park është hartuar dhe plani i menaxhimit (Shtator 2010), i miratuar me urdhër të Ministrit të Mjedisit nr.404, datë 09.06.2011, por që nuk ka gjetur zbatim.

Njëherazi, territori natyror i kompleksit ligatinor të Butrintit (Liqeni i Butrintit, Parku Kombëtar i Butrintit, Kepi i Stillos, ishujt e Ksamilit) ka statusin e Zonë Natyrore veçanërisht e mbrojtur, për t’u përfshirë në listën e Konventës “Për ligatinat me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate të shpendëve ujorë”, me sipërfaqe të përgjithshme 13,500.0ha.

VKM n.881, **datë 03.11.2010**, caktoi vendet për vendosjen e antenave të komunikimit dhe të atyre radiotelevizive në territorin e Parkut Kombëtar “Mali i Dajtit”...

... 3 vjet më parë ...

... miratohet ligji nr.111/2012, **datë 15.11.2012** “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”. Ligji synon: a) mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujor, të ujërave sipërfaqësore, qofshin të përkohshme apo të përhershme, të ujërave të brendshme detare, të ujërave territoriale, zonave ekonomike ekskluzive, shelfit kontinental, të ujërave ndërkufitare, të ujërave nëntokësore, si dhe të statusit të tyre; b) sigurimin, ruajtjen, zhvillimin dhe shfrytëzimin sa më racional të burimeve ujore, të domosdoshme për jetën dhe për zhvillimin social e ekonomik të vendit; c) shpërndarjen e drejtë të burimeve ujore, sipas qëllimeve të përdorimit dhe drejtimin e administrimit e efektshëm të tyre; ç) mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotja, shpërdorimi dhe harxhimi mbi nevojat faktike; d) përcaktimin e kuadrit institucional, në nivel kombëtar e vendor, për vënien në jetë të një politike kombëtare për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore.

Robërimi i Ujit

Tiranë, 6 Tetor 2015 - Në ambientet e Hotel Tirana International zhvilloi punimet Konferenca Kombëtare "Robërimi i Ujit"/Ndikimi mjedisor i HEC-ve të vegjël në rrjedhen ujore.



Konferenca u organizua nga REC Shqipëri në bashkëpunim me WWF, INCA, Milieukontakt, EcoAlbania dhe Eper Center. Konferenca synoi në prezantimin për herë të parë të një studimi profesional ligjor, institucional, socio-ekonomik dhe ekologjik për ndikimin e HEC-ve, nga ana e shoqërisë civile, si dhe formulon gjetje dhe rekomandime alternative mjedisore të këtij zhvillimi.

Në përfundim të konferencës u nënshkrua një kërkesë drejtuar qeverisë shqiptare për moratorium për ndalimin e dhënies së licensave për ndërtimin e HEC-ve për një periudhë tre vjeçare. Në konferencë morën pjesë përfaqësues të Kuvendit të Shqipërisë, të AKZM, të OJF-ve mjedisore, specialistë të mjedisit, etj.

Në linkun e më poshtëm mund të gjeni Deklaratën e pozicionimit të shoqërisë civile mbi alternativën e zhvillimit të sektorit të HEC-eve të vegjël në harmoni me natyrën.

http://www.inca-al.org/index.php?option=com_k2&view=item&id=433:roberimi-i-ujit&Itemid=114&lang=sq



Turizmi në Zonat e Mbrojtura

Korçë, 9 Tetor 2015 – Përfundoi sot në Korçë Konferenca Kombëtare "Turizmit në Zonat e Mbrojtura".

Në këtë konferencë ishin të pranishëm Prefekti i Korçës, Ardit Konomi, Drejtori i AKZM-së, Zamir Dedej, përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit, drejtorë



të disa Zonave të Mbrojtura, përfaqësues të organizmave ndërkombëtar në Shqipëri, përfaqësues të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës, ekspertët mjedisit, etj.

Në fjalën e tij, Drejtori i AKZM-së, Zamir Dedej theksoi se: "Ministria e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura po synon që të zhvillojë turizmin në 365 ditë të vitit dhe jo në një apo dy sezona. Në Zonat e Mbrojtura po zhvillohen shumë projekte, aktivitete të financuara nga donatorët. AKZM do të organizojë të gjithë donatorët për të rritur efikasitetin e Administratave të Zonave të Mbrojtura. Aktualisht kemi 43 pika turistike në Zona të Mbrojtura dhe këtë vit ato janë vizituar nga 418 260 turistë, prej të cilëve 309 mijë kanë qenë vendas dhe 108 mijë të huaj". Zonat më të frekuentuara janë Parku Kombëtar i

Vijon në faqe 4

Vijon nga faqe 3 Malit të Tomorit me 150 mijë turistë, Parku Kombëtar Shebenik–Jabllanicë, Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta, Llogaraja, Liqeni i Pogradecit, Prespa, Lumi i Gashit dhe Butrinti”, tha Zamir Dedej.



Sipas tij, Administratat Rajonale po synojnë të llogarisin turistët që paraqiten pranë zyrve të informacionit për të kërkuar të dhëna mbi një Zonë të Mbrojtur, duke e vizituar atë dhe jo thjesht të frekuentojnë një plazh pranë tij. Kjo bën që komuniteti, turistët vendas dhe të huaj të afrohen me administratat rajonale të Zonave të Mbrojtura.

Kurse Prefekti i Korçës, Ardit Konomi tha se: “Korça është pararojë pasi ka hartuar guidat turistike për zonat e mbrojtura që janë brenda rajonit si dhe po harton saitet e internetit për çdo Zonë të

Mbrojtur”.

Gjatë konferencës diskutimet u fokusuan në vizionin e AKZM-së dhe të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës, sipas të cilëve Zonat e Mbrojtura të mos jenë zona të izoluar, por zona të vizitueshme nga qytetarët vendas dhe të huaja, duke ndryshuar dhe mentalitetin aktual ku rëndom turistët vendas frekuentojnë këto zona të mbrojtura vetëm vlerat gastronomike dhe jo për të shijuar pasuritë natyrore dhe kulturore në këto zona.



Pas përfundimit të Konferencës, të pranishmit zhvilluan një guidë turistike në Parkun Kombëtar të Prespës si një atraksion i veçantë për turizmin natyror, historik dhe kulturor.

Konferenca u organizua nga AKZM në bashkëpunim me Rrjetin për Mbrojtjen e Natyrës dhe KFW.

Rrugëtimi drejt Parisit 2015

Tiranë, 22 Tetor 2015 - U organizua sot në ambientet e Hotel Mondial në Tiranë takimi përmbyllës i Projektit “Rrugëtimi drejt Parisit 2015 për integrimin e çështjeve të Ndryshimeve Klimatike



në politikat dhe dokumentet strategjike të vendit”

Në takim u prezantua dokumenti i politikave strategjike i bazuar në gjetjet dhe rekomandimet që organizatat mjedisore të shoqërisë civile kanë dhënë për qeverinë në përmbushje të angazhimeve kombëtare për arritjen e Kontributit Kombëtar të Pikësnyuar që Shqipëria do të prezantojë në Konferencën e Palëve të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike në Paris.

Dokumenti është hartuar sipas kërkesave të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe rekomandimeve të BE për të integruar çështjet e ndryshimeve klimatike në politikat dhe strategjitë kombëtare dhe për të hartuar plane strategjike në zbatim të këtyre politikave për të shmangur, zbutur

Vijon në faqe 5

Vijon nga faqe 4 apo përshtatur ndaj ndryshimeve klimatike dhe nxitur zhvillimin e vendit në bashkëpunimet rajonale dhe globale me synimin e reduktimit të CO₂ dhe gazeve me efekt serrë.

Takimi u organizuar nga INCA në bashkëpunim me REC Shqipëri në kuadër të Projektit “Rrugëtimi drejt

Parisit 2015 për integrimin e çështjeve të Ndryshimeve Klimatike në politikat dhe dokumentet strategjike të vendit”. Në takim merrin pjesë përfaqësues të institucioneve qendrore, organizatat e shoqërisë civile, grupet e interesit etj.

Vendet e Adriatikut, të bashkuar për të luftuar shpimet për naftë në Adriatik

Split, Kroaci 26-28 Tetor 2015 - Marrëdhëniet bilaterale midis shteteve që rrethojnë Detin Adriatik janë shpesh të influencuara nga problemet politike që lidhen me kufijtë ose me problemet që lidhen me

nga Kroacia, Mali i Zi, Shqipëria dhe Italia për të ngritur një zë më të qartë dhe më të fortë në rajon dhe në nivelet e BE në lidhje me çështjet e mbrojtjes dhe menaxhimit të qëndrueshëm të Detit Adriatik, i cili financohet nga fondi kombëtar Kroat. Midis organizatave është nënshkruar një marrëveshje për platformën e lëvizjes ku janë përfshirë aktivitetet për ngritjen e ndërgjegjësimit, advokimin e politikave të vendeve të Adriatikut si dhe të krijojnë praktika të mira të shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit në mënyrë që të vepohet në përpunje me politikat ndërkufitare dhe respektimit të integritetit tokësor dhe detar.

Në takimin e zhvilluar në Split nga 26-28 Tetor 2015, me pjesëmarrjen e organizatave mjedisore nismëtare të lëvizjes “One Adriatik” nga Kroacia, Italia, Mali i Zi, Shqipëria, Sllovenia dhe Bosnja Hercegovina, ku mori pjesë edhe INCA, duke analizuar situatën e tanishme të aktiviteteve shpim dhe nxjerrje të naftës dhe gazit në detin Adriatik, organizatat pjesëmarrëse bënë një konferencë për shtyp për të adresuar këto problematika qeverive të vendeve të Adriatikut.

Në linkun e më poshtëm mund të gjeni Njoftimin për Shtyp të lëvizjes “One Adriatik”

http://www.inca-al.org/index.php?option=com_k2&view=item&id=436:vendet-e-adriatikut-te-bashkuar-per-te-luftuar-shpimin-e-naftes-ne-detin-adriatik&Itemid=114&lang=sq

shfrytëzimin e burimeve natyrore (si p.sh. peshkimi). Çështjet e përdorimit të burimeve natyrore mbeten gjithmonë çështje të dorës së dytë/ose më pak të rëndësishme. Shurdhësia politike në lidhje me menaxhimin e burimeve natyrore ka dhënë efekte të shumëfishuara dhe të akumuluar në vite duke dhënë efekte në qëndrueshmërinë e ekosistemeve të Detit Adriatik. Planet për nxjerrjen e naftës nga qeveritë e Kroacisë, Italisë, Malit të Zi dhe Shqipërisë janë bërë të veçuara nga njëri-tjetri dhe në mënyrën më të mirë ilustrojnë shfrytëzimin në formën më të paqëndrueshme të këtyre burimeve.

Në mënyrë që të shmangen”tragjeditë e përbashkëta”të udhëhequra nga ideja e ekzagjeruar e nxjerrjes së naftës sepse “fqinji po e bën këtë, pse të mos e bëj dhe unë”, është e domosdoshme të ndërmerren përpjekje për të rritur ndërgjegjësimin e organizatave mjedisore në të gjithë rajonin e Adriatikut.

Për këtë është organizuar lëvizja “One Adriatik”e cila përfshin pjesëmarrjen e organizatave mjedisore



Jeste li za ili protiv istraživanja i eksploatacije nafte u Jadranu?



Workshop informativ - Milieukontakt

Vlorë, 27 Tetor 2015 - Milieukontakt International Shqipëri (MIA) dhe Këshilli i Qarkut Vlorë, organizuan Workshopin informativ të projektit “Rrjeti Satelitor i Monitorimit në Kohë Reale të Rrezikut të Eutrofikimit të ujrave detare në zonën ndërkufitare Shqipëri-Greqi”. Projekti bashkëfinancohet nga Bashkimi Evropian dhe fondet kombëtare të Greqisë dhe Shqipërisë, në kuadër të Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA “Greqi-Shqipëri 2007-2013”.

Workshopi mbledhi në tryezë partnerët e projektit MIA, Këshillin e Qarkut Vlorë, Drejtorinë e Ujrave të Epirit (EDW) dhe përfaqësues nga institucionet publike si: Ministrinë e Bujqësisë, AKM, ARM, AdZM, Agjencinë e Basenit të Vjosës, Prefektura Vlorë dhe OJF. Qëllimi i workshopit ishte prezantimi i projektit SAIMON, informimi i komunitetit shkencor dhe publikut të gjerë për risqet që paraqet eutrofikimi i ujrave detare si dhe risitë teknologjike që do të shfrytëzojë projekti në monitorimin e të dhënave në kohë reale në të dy anët e kufirit Shqipëri- Greqi.

Kryetari i Qarkut Vlorë, Z. Sadrit Danaj i cili reflektoi rëndësinë e zbatimit të projektit në Qarkun e Vlorës, bashkëpunimin institucional me të tre partnerët e projektit theksoi se: *Eksperienca e përftuar deri më tani në drejtimin e projekteve ndërkufitare në IPA “Greqi-Shqipëri 2007-2013” shtron përpara nesh angazhim të aktorëve lokale dhe kombëtar për të ngritur një agjensi ndërinstitutionale të përbashkët, ku të përfshihen institucione, shoqata, bizneset dhe individë për zhvillimin ekonomik të qarkut dhe rritjen e cilësisë e jetesës në të dy krahët e kufirit Shqipëri-Greqi.*

Duke e parë cilësinë e ujit si një tregues të fortë të zhvillimit të turizmit në zonën e jugut, projekte të tilla si SAIMON duhen për të adresuar problematika që mund të krijohen. Pjesëmarrja e specialistëve nga të gjitha institucionet përkatëse në zbatim të projektit, është e rëndësishme që ky projekt t'i shërbejë gjithë zonës duke shtuar tregues dhe pika të tjera në monitorim”.

Znj.Valbona Mazreku, drejtuese e MIA theksoi se koordinimi në nivel vendor që po realizon qarku është një iniciative premtuese për të ndërmarrë hapa konkretë që prekin realitetin dhe adresojnë dhe evidentojnë problemet e mjedisore deri në zgjidhjen e tyre nga autoritetet përkatëse. Ndërkohë MIA po e bën këtë koordinim në nivel kombëtar duke ndërvepruar me institucione si Ministri të linjës, AKM dhe projekte të organizatave ndërkombëtare për ta ngritur çështjen nga niveli vendor në atë qendror duke punuar njëkohësisht me ndërgjegjësimin e komunitetit.

Nga partnerët grek, përfaqësues i Drejtorisë së Ujrave të Epirit, Z. Konstantinos Galanis shpjegoi se sa rëndësi ka zbatimi i Direktivës Kuadër të Ujit për të dy rajonet kufitare dhe theksoi se bashkëpunimi në adresimin e problemeve të përbashkëta mjedisore por dhe përshtatshmëria e legjislacioneve në fuqi të të dy vendeve me udhëzimet e direktivës së Ujit janë një element për të rritur standartet dhe zbatimin e efektshëm të saj në Greqi dhe Shqipëri.

Workshopin e përshëndetën dhe përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë, AKM dhe projekteve në zonë duke theksuar angazhimin për bashkëpunim dhe sinergji mes projekteve të tyre.

Nga MILIEUKONTAKT SHQIPERI

Ndikimet mjedisore që vijnë nga aktiviteti minerar në Bulqizë

Nga Danjel Bica (Ekspertët e Rinj Mjedisor)

Bulqiza shtrihet në pjesën verilindore të Shqipërisë, me një lartësi që shkon nga 330-1800m mbi nivelin e detit, me një sipërfaqe 728 km², ndërmjet koordinatave gjeografike në veri shtrihet në +41° 30' 43.10" dhe në lindje +20° 14' 56.21". Sipërfaqja urbane e qytetit të Bulqizës është 0,6 km² me një sipërfaqe administrative 45,6 km², e cila përbën

6,26% të sipërfaqes së përgjithshme të Bulqizes. Popullsia që jeton në qytetin e Bulqizës është 13000 banorë, ndërsa i gjithë rrethi numeron 43.000 banorë.

Si çdo qytet tjetër në Shqipëri edhe këtu janë prezente problematika të shumta mjedisore që hasen në këtë zonë, ku një nga më kryesoret janë mbetjet e kromit, si pasoje e hapjeve të galerive

Vijon në faqe 7



Vijon nga faqe 6

të shumta private, karrierat e kromit që gërmojnë tokën në shtresat sipërfaqësore, kanë çuar në shkatërrimin e tokës dhe sipërfaqeve të gjelbra që nuk respektojnë lejen mjedisore ose një pjesë e mirë e tyre, nuk janë të licensuara fare. Mjedisi në këtë zonë është problematik, pasi mbeturinat e dala nga kromi apo inerte thidhen në sipërfaqe, pa ndonjë rregull si të caktuar, duke mbuluar sipërfaqen bimore, duke çuar në degradimin e tokës dhe sipërfaqe spërreth, që shoqërohet dhe me humbje të habitatit përkatës në atë zonë.

Por, kemi dhe një ndotje të ujit nëntokësor, pasi uji i dalë nga pusët e galerive përmban grimca të ngurta, mineralizimi i ujërave i përket tipit, hidrokarbonat magnezit, me pH 4.8- 5. Elementet e ndotjes që përmban uji vijnë nga lënda plasëse që është e tipit amonit si dhe nga gazrat që dalin në thellësi mbi 800 m. Natyra e ujit të Bulqizës quhet agresive, ajo gërryen dhe betonin se është e tipit magnezial, uji është me fortësi maksimale, megjithatë nuk ka ndonjë rregullsi të këtij uji që del nga minierat në sipërfaqe.

Më poshtë, po ilustruam problemet mjedisore të gjetura: Minierat e kromit, inertet, mbeturinat (të të gjitha llojeve), ndërtimet pa leje, ujërat e larta (deluvionet që vijnë si rezultat i ujërave të larta)

Idetë dhe strategjitë për përmirësimin e situatës mjedisore

Duke pasur parasysh problemet mjedisore që ndodhen në këtë zonë, ndërhyrjet për përmirësim janë të shumta, por theksojmë se të gjitha minierat e kromit duhen të paisen me leje mjedisore sipas

ligjit Nr.10448 date 14.07.2011, dhe të zbatojnë të gjitha pikat që përmban ajo në zbatimin me ligjin Nr.10431, datë 9.6.2011 për Mbrojtjen e Mjedisit, inertet apo mbetjet e dala në sipërfaqe të mos demtojnë mjedisin përreth, vetëm në lejen e caktuar, t'u bëhet pritë ujërave nën tokësore.

Të bëhet një trajtim i mirë i mbetjeve, të mos lihen të lira në sipërfaqe, është e domosdoshme ndërtimi i një landfilli dhe një projektim për vend depozitimin e mbetjeve. Studimi i mbetjeve ka përcaktuar se më shumë se 50% e mbetjeve bashkiake është aktualisht e biodegradueshme, që do të thotë se sipas Direktivës së BE për landfillet, që është e domosdoshme ndërtimi i një landfilli përfaktin se ky imponon një ndarje të konsiderueshme të mbetjeve të degradueshme nga mbetjet që përfundojnë në landfill. Për më tepër, ka sasira të konsiderueshme të materialeve që mund të riciklohen si qelqi, tekstile dhe plastika etj. Sasia e mbetjeve të prodhuara nga shëndetësia është e ulët, për faktin se mbetjet grumbullohen zakonisht në pikën e gjenerimit dhe marrja e mostrave nuk është kryer në strukturat shëndetësore.

Bashkia të marrë masa në ndërtimet pa leje, duke mos lejuar ndërtimin e tyre, ujërat e rrjedhshëm si ato të dala nga nëntoka dhe ato sipërfaqësorë t'u bëhen prita dhe t'u jepet një drejtim i mirë i tyre. Drenazhimi i zonës është dhe një problem tjetër që duhet rishikuar me kujdes, por që të zbatohen të gjitha këto pika të përmendura më sipër, duhet që të bëhet dhe një studim i mirë mjedisor i të gjithë zonës dhe fondet për mbrojtjen e mjedisit të mos jenë të kursyeshme, dhe duhet të punesohet një grupim ri ekspertësh në fushën mjedisore.

Duke pasur parasysh nga çka thamë më sipër, për zonën evojiten:

Ndërhyrje në aspektin mjedisor, të zbatohen të gjitha ligjet mjedisore. T'u jepet leja mjedisore përshfrytëzimin e aktiviteteve, personave që plotësojnë kushtet e lejes. Bashkia e Bulqizës duhet të jetë me kujdes në aspektet mjedisore. Mjedisi në zonën e Bulqizës, pa mbështetjen dhe ndergjegjësimin e banorëve, po shkon drejt degradimit pasi ata nuk janë të mirë informuar, kështu mungojnë organizatat mjedisore dhe donatorët e huaj

Vijon në faqe 8

Vijon nga faqe 7 për investimet dhe mbështetje. Kjo, si rezultat i keq menaxhimit të mjedisit nga banorët dhe pushteti vendor.

Jam i mendimit se duhet të jetë më e vëmendshme në problematikat mjedisore të zonës. Zhvillimi i planit të mbetjeve me objektiva strategjike që të përcaktojnë qartëaktivitetet dhe rezultatet e pritura. Duhet të përcaktohen planet përfundimtare për depozitimin, trajtimin e mbetjeve veçanërisht në qoftëse lidhet me një zonë tjetër, si në rastin konkret: Një plan menaxhimi për mbetjet e rrezikshme që përfshijnë një plan riparimi për zonat e demtura gjatë aktivitetit minerar ku nuk është zbatuar plani i

rehabilitimit. Krijimi i qendrave të trajtimit të mbetjeve për sterilizimin dhe trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore. Riparimi i vend depozitimeve egzistuese përmë betjet urbane në Bulqizë (x2) Bulqizaka sipërfaqe të konsiderueshme të zhveshura nga pyjet që ndikojnë negativisht në mbrojtjen e tokës nga erozioni. Përkëthësye, mbrojtja e mjedisit do të fokusohet kryesisht në shtimin e pyjeve si dhe në mbrojtjen e burimeve të tjera natyrore nga degradimet që mund të vijnë si rezultat i keq menaxhimeve.

Nga Danjel Bica
(Eksptetë e Rinj Mjedisor)

NJOFTIME

8 Nëntor - Dita Botërore e Urbanizimit

18 Nëntor - Dita Botërore e Sistemeve të Informacionit Gjeografik (GIS)

25 Nëntor - Dita Botërore e Ndërkombëtare e Eliminimit të Dhunës ndaj Grave

- 1 - *The European Topic Centre on Biological Diversity (ETC/BD) is seeking a " Biodiversity information Officer", for its office in Paris / <http://bd.eionet.europa.eu> / http://bd.eionet.europa.eu/publications/Biodiversity_information_Officer.pdf*
- 2 - MEDfOR applications are NOW open for Erasmus Mundus scholarships and self-funded students, for the 2016/2017 edition. Deadline: January 15th, 2016.
<http://www.medfor.eu/>
- 3 - Për të lexuar **"Ditari i Natyrës"** në vite...
http://www.inca-al.org/index.php?option=com_k2&view=itemlist&layout=category&task=category&id=15&Itemid=195&lang=sq

Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

- Rrjeti i Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi ti publikoni në ditarin e saj elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 150 - 200 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes ditarit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia mban të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme. Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme. Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

- Ky botim është mundësuar nga një grant i dhënë nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri përmes programit SENIOR-A. Ky publikim paraqet pikëpamjet e autorit/autorëve mbi këtë temë. Këto pikëpamje nuk janë adoptuar apo aprovuar nga REC Shqipëri dhe nuk duhet të shihen si qëndrime të tij apo të Ambasadës Suedeze në Shqipëri. REC Shqipëri nuk garanton saktësinë e të dhënave të këtij publikimi e nuk mban përgjegjësi për përdorimin e tij.

Botim i Rrjetit të Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës / Redaksia: Ilirjan Qirjazi; Vilma Kadiu; Marinela Mitro

Rr. Islam Alla, Pall IVEA, Kati I, Tiranë; Tel/Fax: + 355 4 2231 437
www.inca-al.org; info@inca-al.org; www.facebook.com/inca.albania